



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
-Kuvendi i Komunës-

01Nr. 60/01-1230/26 /26
Kaçanik, 30.01.2026

Në bazë të Vendimit të KQZ-së, Nr. 01/33-2026 të datës 12.01.2026, protokolli i komunës 01Nr. 60/01-1230/26 i datës 14.01.2026, me të cilin është caktuar Zëvendësimi i anëtarit të dorëhequr, Xhelal Dema, me kandidatin e radhës nga po i njëjti subjekt politik Partia Demokratike e Kosovës- PDK, Ibrahim Imishti, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 30.01.2026, i konstatoj:

**Ndryshim Plotësimin e Përbërjes së Kuvendit të Komunës Kaçanik
të Legjislaturës së tetë (8) të zgjedhur me 12 Tetor 2025**

- 1. BRAHIM IMISHTI** – nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës-PDK sipas Vendimit të KQZ Nr. 01/33-2026 të datës 12.01.2026 (bashkangjitur kësaj shkrese) është emëruar, Anëtar i Kuvendit të Komunës Kaçanik, në vend të Anëtarit të dorëhequr të Kuvendit të Komunës Kaçanik, Xhelal Dema.
2. Betimin për Anëtar të Kuvendit të Komunës, Ibrahim Imishti e ka dhënë në mbledhjen e Rregullt të Kuvendit të Komunës më datë: 30.01.2026. Nga kjo datë realizon të gjitha të drejtat dhe detyrat si anëtarët tjerë të Kuvendit të Komunës, përfshirë edhe çështjen e kompensimit.
3. Anëtari i Kuvendit të Komunës Kaçanik nga pika 1 e kësaj shkrese, më rastin e dhënies së Betimit Solemn dhe nënshkrimit të Deklaratës Solemne, para Kuvendit të Komunës, u zotua se merr përsipër detyrat e anëtarit të Kuvendit Komunal të përcaktuara si në dispozitat e nenit 35.4 të LVL.
4. Mandati i anëtarit të Kuvendit të Komunës është i lidhur më mandatin e Kuvendit të Komunës, fillon nga data e emërimit në këtë post, respektivisht pas dhënies së Betimit Solemn dhe nënshkrimit të Deklaratës Solemne për Anëtar të Kuvendit të Komunës Kaçanik, ndërsa përfundon sipas dispozitave të nenit 37.2 të LVL.
5. Obligohen organet relevante të komunës t'i marrin veprimet e nevojshme për futjen në Listën e Pagave anëtarin e Kuvendit të Komunës, Ibrahim Imishti dhe heqjen nga Lista e Pagave, anëtarin e dorëhequr, Xhelal Dema.

Me këtë shkresë njoftohen: Kryetari i Komunës; Zyra e Personelit; Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Selajdin Troni





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

Data	30.01.26	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë	
01	60/01-2624	-	

Në bazë të nenit 35.4 dhe 35.5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, anëtar i zgjedhur i Kuvendit të Komunës, e jep Betimin dhe nënshkruan Deklaratën Solemne, në mbledhjen e I-r të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2026, mbajtur me 30 janar 2026, si vijon:

BETIM

Unë, Brohim Imishli, “Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

Vendi, Kaçanik,

Data, 30.01 2026

Emri dhe mbiemri i anëtarit të Kuvendit të Komunës Kaçanik

Brohim Imishli Nënshkrimi [Signature]



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



I	Data	14.01.2026	Vendi	KAÇANIK
II	Org.	Numri	Shtojcë	
	01	60/01-1230-1		



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Centralna Izborna Komisija Central Election Commission
12-01-2026
Prishtinë / Priština
Nr./Br. 0133-2026

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 63 të Ligjit Nr. 08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (c) të Ligjit Nr. 03L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017 për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, si dhe nenin 41 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes votimit në procedurë qarkulluese, më datë 12.01.2026, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Emërimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal

- I. **Z. Brahim Imishti**, emërohet anëtar i kuvendit komunal në Kaçanik, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës - PDK", duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal **z. Xhelal Dema**.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z. Brahim Imishti dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 09.01.2026 me numër të protokollit 07/7-16/2026, për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal, i cili ka dhënë dorëheqje për arsye personale. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati i radhës në listën e rirenditur është Brahim Imishti. Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimin të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, duke ruajtur kuotën prej 30 %, të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuara të zgjedhjeve lokale të vitit 2025. Andaj, pas plotësimit të kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë, 12.01.2026

Kreshnik RADONIQI

Kryesues i KQZ

